



## KONKURS PËR PUNË

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

### **Ligjërues/Asistent me angazhim për lëndët e programit certifikues**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Ligjëruesit/Asistentit**

- Ligjëron lëndët e programit certifikues bazuar në materialet dhe plan-programin e përcaktuar nga ShKÇAK;
- Bashkëpunon dhe ndihmon kandidatët në arritjen e objektivave të lëndës përkatëse;
- Merr pjesë në rishikimet periodike të materialeve të trajnimit dhe në rast nevojë edhe azhurnimi i tyre;
- Përgatit materiale mësimore shtesë për kandidatët;
- Bashkëpunon me Departamentin e Edukimit dhe Standardeve Profesionale drejt implementimit të kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve;

#### **Kualifikimet dhe përvoja:**

- Diplomë Universitare në Ekonomi (preferohet të jetë anëtar i SHKÇAK ose i ndonjë shoqate tjetër profesionale të njohur ndërkombëtarisht);
- Përparësi kanë kandidatët të cilët janë së paku “Teknik të Kontabilitetit” të ShKÇAK ose kanë të përfunduar studimet master;
- Eksperiencë në ligjërime ose gatishmëri për të ligjëruar;
- Përvojë të punës praktike në kontabilitet, tatime dhe auditim;
- Aftësi të mira komunikuese dhe ndër njerëzore;
- Njohja e gjuhës angleze është e preferuar;
- Njohuri në kompjuter;
- Kandidatët kërkohet të kenë vetiniciativë për zhvillim të mëturjesëm të plan-programit dhe zhvillim të procesit të certifikimit;

Referencat janë të domosdoshme dhe duhet të dërgohen me CV.

**Dorëzoni CV-në tuaj në E-mail adresën: [info@scaak.org](mailto:info@scaak.org)**

**Për pozitën: Ligjërues/Asistent me angazhim (i jashtëm) për lëndët e programit certifikues**

CV-të i pranojmë deri me 20/09/2022

**Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur**